



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 261/ 19
263/ 19
280/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”, OE-“Konz NTP Begisholli & Conex Group” dhe OE-“Gërlica Company”shpk kundër vendimit të autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull:“Asfaltimi i rrugës Pleshinë–Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar” me numër të prokurimit:656/17/3827/511 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)“Komuna Ferizaj”më datën 25.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik:“Konz KNPSH Papenburge r&Adriani Company & Eskavatori & Best Company shpk”, ankesa e OE-Konz NTP “Begisholli & Conex Group” dhe ankesa e OE-“Gërlica Company”shpk, kundër vendimit të autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Asfaltimi i rrugës Pleshinë–Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar” me numër të prokurimit:656/17/3827/511 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- Komuna Ferizaj.

II. ANULOHET, vendimi i autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull“Asfaltimi i rrugës Pleshinë–Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar” me numër të prokurimit:656/17/3827/511 AK-“Komuna Ferizaj” dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”, OE-“Konz NTP Begisholli&Conex Group” dhe OE-“Gërlica Company” shpk aprovohen si te bazuara, operatorve ekonomik ankues iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:15.08.2017

Data e hapja së ofertave:26.09.2017

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit te pasuksesshem: 14.05.2019

Data e njoftimit per anulimin e aktivitetit te prokurimit : 07.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim OE Gërlica-Company SHPK:17.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim OE KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatoti.16.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim OE NTP Begisholli&Conex Group: 20.05.2019

Autoriteti Kontraktues-“Komuna Ferizaj” me datën 22.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”, OE-“Konz NTP Begisholli&Conex Group” dhe OE-“Gërlica Company”shpksi të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues -“Gërlica Company”shpk me datën 29.05.2019,me nr.prot: 261/19 OE-“Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”me datën 30.05.2019 me nr prot: 263/19 dhe OE- “Konz NTP Begisholli&Conex Group” me datën 03.06.2019 me nr prot: 280/19 si palë te pa kenaqura, kanë deponuar ankesë në OSHP, kundër vendimit për anulim te aktivitetit e prokurimit me titull“Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar” me numër të prokurimit:656/17/3827/511 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -“Komuna Ferizaj” duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Sipas OE- ankues-“Gërlica Company”Autoriteti kontraktueska vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe neni 62të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Sipas OE-ankues -“Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”Autoriteti kontraktueska vepruar në kundërshtim me nenin 1,10,43 si dhe neni 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Sipas OE- ankues-“Konz NTP Begisholli&Conex Group”Autoriteti kontraktueska vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,62,72,108.4, 115.6 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39.8 i RrUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:17.06.2019,lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues “Konz KNPSH Papenburger & Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”, OE-“Konz NTP Begisholli&Conex Group” dhe OE-“Gërlica Company”shpk në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin ankimore të Operatoreve ekonomik ankues të larte cekur sa i përket arsyetimit për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga ana Autoritetit kontraktues Komuna Ferizaj bazuar ne atë qe është përshkruar ne Njoftimin për anulim ku thuhet: “një dispozitë e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, e parapare ne nenin 62 te LPP-së”.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se ky aktivitet i prokurimit është kthyer ne rivlerësim nga ana e OSHP-se ne baze te vendimit nr. 483,485/17 te dt. 27.12.2017. Autoriteti kontraktues me dt.14.05.2019 ka publikuar Njoftimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Eksperti shqyrtues njëherit sqaron se kemi te bëjmë me një pretendim ankimor kundër anulimit te këtij aktivitetit andaj ankesat OE-ve kane një pretendim te vetëm ankimor, në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga Operatoret Ekonomik te larte cekur ankues sa i përket anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit sipas arsyetimit të dhënë nga ana Autoriteti kontraktues, vlerësoj se NUK qëndron arsyetimi i dhënë bazuar në nenin 62 të LPP-së, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi në lidhje me arsyetimin për anulim te këtij aktiviteti. Poashtu Autoriteti kontraktues ne njoftimin për anulim vetëm thekson duke u thirrur në nenin 62 te LPP-se pa ofruar ndonjë të dhënë të saktë provë apo dokument që dëshmon sipas nenit 62 të LPP-së, paragrafi 1.1. Po ashtu ky aktivitet i prokurimit fillimisht është vlerësuar duke rekomanduar për dhënien e kontratës, por i njëjti aktivitet pas vendimit të OSHP për të kthyer në rivlerësim këtë procedurë ndërsa AK-ja ka bërë anulimin aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e AK-së si dhe arsyetimin e dhënë për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit mendoj se nuk është sqaruar dhe arsyetuar vendimi për anulimin e procedurës konform nenit 62 të LPP-së, siç kërkohet një arsyetim detal me të dhëna faktike konform këtyre dispozitave për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimet tjera ankimore të parashtruar nga ana OE ankues NTP Begisholli & Conex Group, sa i përket referencave dhe formularit të tenderit si dhe nenit 72 të LPP-se për të sqaruar këto dokumente, njoftoj panelin shqyrtues në harmoni me Rregulloren e brendshme të OSHP-se neni 16.2 se të njëjtat pretendime ankimore janë shqyrtuar paraprakisht në baze të vendimit P. SH. nr. 483/17 dhe 485/17, dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues Rekomandon që të aprovohen si të bazuar ankesat e parashtruar nga operatorët ekonomik ankues të lartë cekur, njëherit ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik ankues “Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”, përmes parashtresës me shkrim të datës:17.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik ankues OE-“Gërlica Company”shpk përmes parashtresës me shkrim të datës: 17.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer fare përgjigje Panelit shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues apo jo.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues për arsyeje të pa njohura, nuk ishte prezent në seance, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-ankues z. Dervishi deklaroi: Qëndrimi i AK dhen për njoftimin për anulimin e tenderit bie ndesh me nenin 62 parag.1 dhe 2 të LPP-së sepse një anulimi i tillë

behet pa dhen një arsyetim, për këtë arsye konsideroj që procesi të kthehet në rivlerësim, pajtohem me mendimin e ekspertit.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-së së dytë ankues z. Begisholli deklaroj: Është bërë shkelje e neni 62 të LPP-së dhe pajtohem me mendimin e dhen nga eksperti shqyrtues që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-së së tretë ankues z. Thaçi deklaroj: edhe në deklarojmë si përfaqësuesit e OE-ve të tjera ankuese që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të neni 62 të LPP-së dhe po ashtu pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së tretë ankuese deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e “Konz KNPSH “Papenburg & Adriani Company & Eskavatori & Best Company shpk”, OE-“Konz NTP Begisholli & Conex Group” dhe OE-“Gërlica Company” shpk.

Lidhur me pretendimin ankimore të Operatoreve ekonomik ankues të lartë cekur sa i përket arsyesimit për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga ana e Autoritetit kontraktues Komuna Ferizaj bazuar në atë që është përshkruar në Njoftimin për anulim ku thuhet: “një dispozitë e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, e parapare në nenin 62 të LPP-së”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit është kthyer në rivlerësim nga ana e OSHP-së, në bazë të vendimit nr. 483,485/17 të dt. 27.12.2017. Autoriteti kontraktues me dt. 14.05.2019 ka publikuar Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional një herit sqarojnë se kemi te bëjmë me një pretendim ankimor kundër anulimit të këtij aktivitetit andaj ankesat OE-ve kane një pretendim të vetëm ankimor, në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga Operoret Ekonomik te larte cekur ankues sa i përket anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit sipas arsytimit të dhënë nga ana Autoriteti kontraktues, vlerësoj se NUK qëndron arsyetimi i dhënë bazuar në nenin 62 të LPP-së, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi në lidhje me arsyetimin për anulim të këtij aktiviteti. Po ashtu Autoriteti kontraktues ne njoftimin për anulim vetëm thekson duke u thirrur në nenin 62 të LPP-se pa ofruar ndonjë të dhënë të saktë provë apo dokument që dëshmon sipas nenit 62 të LPP-së, paragrafi 1.1. Po ashtu ky aktivitet i prokurimit fillimisht është vlerësuar duke rekomanduar për dhënien e kontratës, por i njëjti aktivitet pas vendimit të OSHP për të kthyer në rivlerësim këtë procedurë ndërsa AK-ja ka bërë anulimin aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se duke u bazuar në dokumentacionin e AK-së si dhe arsyetimin e dhënë për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit konstatojmë se nuk është sqaruar dhe arsyetuar vendimi për anulimin e procedurës konform nenit 62 të LPP-së, siç kërkohet një arsyetim detal me të dhëna faktike konform këtyre dispozitave për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimet tjera ankimore te parashtruar nga ana OE ankues NTP “Begisholli&Conex Group, sa i përket referencave dhe formularit te tenderit si dhe nenit 72 te LPP-se, paneli shqyrtues sqaron se te njëjtat pretendime ankimor janë shqyrtuar paraprakisht ne baze te vendimit P. SH.nr. 483/17 dhe 485/17 , dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetem Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –“Komuna Ferizaj”
- 1x1 OE-“Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk”,
- 1x1 OE-“Konz NTP Begisholli&Conex Group”
- 1x1 OE-“Gërlica Company”shpk
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

